

P O L I T I K A E M B I K Ë Q Y R J E S

BANKA E SHQIPËRISË

1. HYRJJE

Ky dokument përcakton politikën e mbikëqyrjes të bazuar në rrezik për bankat dhe grupet bankare ose financiare (të cilave, për thjeshtësi, këtu e më poshtë në këtë dokument, do t'u referohemi si "banka") për të cilat Banka e Shqipërisë është autoriteti mbikëqyrës përgjegjës. Objektivi kryesor i mbikëqyrjes së bazuar në rrezik është që të sigurojë një proces efikas për vlerësimin e gjendjes financiare dhe të qëndrueshmërisë së bankave. Banka e Shqipërisë, duke marrë në konsideratë edhe veçoritë e veprimtarisë financiare që ushtrojnë institucionet e tjera financiare të licencuara prej saj, zbaton pjesë të caktuar të kësaj politike edhe për këtë kategori.

2. KUPTIMI I MBIKËQYRJES SË BAZUAR NË RREZIK

Mbikëqyrja bankare është një proces i strukturuar, i projektuar për të identifikuar faktorët kryesorë të rrezikut ndaj të cilëve ekspozohen bankat individuale, si dhe i gjithë sistemi bankar.

Ndërsa, mbikëqyrja e bazuar në rrezik mundëson kalimin nga një mbikëqyrje tradicionale e bazuar në rregulla të ngurta, në një mbikëqyrje që bazohet dhe i kushton një vëmendje më të madhe maturisë së mbikëqyrësit dhe gjykimit të tij profesional. Kjo i mundëson mbikëqyrësit një fleksibilitet më të lartë për t'u fokusuar në ato fusha që shfaqin rrezik material, aktual dhe potencial. Rrjedhimisht, aktivitetet që paraqesin rrezik më të lartë, shqyrtohen më në detaj dhe, në këtë mënyrë, vëmendja mbikëqyrëse fokusohet në ato rreziqe apo banka që paraqesin dobësi serioze apo prirje negative.

Më tej, ky proces ka për qëllim vlerësimin e politikave dhe praktikave të administrimit të rrezikut të përdorura për zbutjen e tij, dhe përqendron burimet mbikëqyrëse bazuar në karakteristikat e rrezikut të bankave. Ai merr në konsideratë - në mënyrë sistematike - të gjitha aktivitetet kryesore funksionale të një institucioni bankar (linjat e biznesit apo fushat operacionale) dhe, brenda secilit prej tyre, vlerëson shkallën, cilësinë e administrimit dhe orientimin ndaj rrezikut.

Mbikëqyrja e bazuar në rrezik inkurajon bankat të përmirësojnë vazhdimisht administrimin e rreziqeve dhe të kryejnë shpërndarjen e kapitalit në përputhje me to, si dhe përdorimin e modeleve të brendshme të sofistikuar.

Në kuadrin e mbikëqyrjes së bazuar në rrezik dhe duke pasur parasysh dinamizmin në zhvillimet e situatës së bankave individuale dhe të sistemit bankar në tërësi, përpjekjet e mbikëqyrësve gjatë mbikëqyrjes nga jashtë dhe në vend, janë një proces i vazhdueshëm. Kjo nënkupton se, shqetësimet mbikëqyrëse të identifikuar gjatë kryerjes së analizave nga jashtë do të shërbejnë si bazë për rritjen e vëmendjes mbikëqyrëse dhe ndërmarrjen e masave përkatëse. Nga ana tjetër, mangësitë e identifikuar gjatë ekzaminimeve në vend, janë subjekt i monitorimit nga jashtë, përgjatë harkut kohor të ekzaminimeve të njëpasnjëshme në vend.

3. PËRPARËSITË E MBIKËQYRJES SË BAZUAR NË RREZIK

Mbikëqyrja e bazuar në rrezik sjell një sërë përparësish, si për mbikëqyrësit ashtu edhe për bankat, dhe konkretisht:

1. fokusohet në mbikëqyrjen e bankave dhe aktiviteteve që shfaqin një rrezik më të lartë apo prirje negative;
2. nxit bankat për përmirësimin e aftësisë së tyre për të identifikuar, matur, monitoruar dhe kontrolluar rreziqet, si dhe për të korigjuar mangësitë e vërejtura përgjatë këtyre proceseve;
3. inkurajon komunikime të shpeshta dhe të hapura ndërmjet bankave dhe mbikëqyrësve, të cilat sigurohen nëpërmjet takimeve në faza të ndryshme të procesit dhe i mundësojnë mbikëqyrësve të kuptojnë më mirë strategjinë e bankës, rreziqet me të cilat përballet ajo, cilësinë e administrimit të rrezikut, si dhe arritjet në adresimin e mangësive të identifikuara gjatë procesit mbikëqyrës;
4. përmirëson cilësinë e punës së mbikëqyrjes bankare, për shkak se zhvillimet e reja dhe ndryshimet strategjike në një institucion të caktuar apo zhvillimet sektoriale në rreziqe specifike monitorohen në mënyrë më të detajuar, përgjatë gjithë ciklit mbikëqyrës;
5. siguron një administrim më të mirë të burimeve njerëzore nga pikëpamja kohore, duke mundësuar shkurtimin e kohës së shpenzuar gjatë mbikëqyrjes në vend, në kushtet kur analiza paraprake kryhet nga jashtë.

4. PARIMET E MBIKËQYRJES SË BAZUAR NË RREZIK

Procesi i mbikëqyrjes së bazuar në rrezik udhëhiqet nga tre parime kryesore.

1. *Parimi i orientimit sipas profilit të rrezikut.* Ky parim konsiston në ndërtimin e procesit mbikëqyrës mbi bazën e profilit të rrezikut të bankës, i cili lidhet kryesisht me madhësinë dhe me peshën e saj në sistem, si dhe me karakteristikat e rrezikut të veprimitarisë së saj. Qëllim është rritja e eficiencës dhe optimizimi i përdorimit të burimeve mbikëqyrëse, nëpërmjet një procesi planifikimi bazuar në prioritete.
2. *Parimi i konsolidimit.* Në zbatim të këtij parimi, mbikëqyrja e një banke shtrihet edhe në aktivitetet ose personat e lidhur me bankën. Mbikëqyrja e konsoliduar, në rastet që është e mbështetur ligjërisht, zbatohet në mënyrë të drejtpërdrejtë mbi subjektet e lidhura ose nëpërmjet bashkëpunimit me autoritete të tjera mbikëqyrëse.
3. *Parimi i proporcionalitetit.* Ky parim nënkupton se zbatimi i procedurave mbikëqyrëse do të kryhet duke mbajtur parasysh madhësinë dhe natyrën komplekse të subjekteve që ekzaminohen, si dhe rëndësinë e tyre sistematike.

5. PROFILI I RREZIKUT TË BANKAVE

Përcaktimi i profilit të rrezikut është procesi i vlerësimit të cilësisë së veprimtarisë së bankës, duke vlerësuar rreziqet ndaj të cilave është ekspozuar ajo dhe cilësinë e punës për administrimin dhe zbutjen e tyre.

Përcaktimi i profilit të rrezikut të bankës do të jetë një shumatore e vlerësimit të rreziqeve individuale dhe të dy elementeve të veçanta, të ponderuara me peshat përkatëse. Rreziqet që vlerësohen gjatë përcaktimit të profilit të rrezikut listohen si më poshtë.

1. Rreziku strategjik
2. Rreziku organizativ
3. Rreziku i kredisë
4. Rreziku i likuiditetit
5. Rreziku i tregut
6. Rreziku i normës së interesit në librat e bankës
7. Rreziku operacional dhe reputacional

Ndërsa elemente të veçanta do të jenë:

- përfitueshmëria; dhe
- mjaftueshmëria e kapitalit.

Sistemi i vlerësimit të rreziqeve, i cili pasqyrohet edhe në përcaktimin e profilit të rrezikut të bankës, është një sistem i përshkallëzuar me 6 nivele, ku niveli 1 tregon nivelin më të ulët të rrezikut, ndërsa niveli 6 tregon nivelin më të lartë të tij.

Në kuadrin e trajtimit të rreziqeve, rreziku i likuiditetit, i tregut dhe i normës së interesit në librat e bankës, do të përkufizohen si “rreziqe financiare”.

6. CIKLI I MBIKËQYRJES

Cikli i mbikëqyrjes përkufizohet si periudha maksimale ndërmjet dy vlerësimeve të profilit të përgjithshëm të rrezikut të bankës, ku përfshihen edhe aktivitetet mbikëqyrëse të planifikuara gjatë kësaj periudhe.

Në kushte normale, profili i rrezikut, do të rishikohet një herë në vit (kryesisht brenda tremujorit të parë të vitit pasardhës)¹, duke përfshirë në vlerësim informacionin nga mbikëqyrja në vend dhe nga mbikëqyrja nga jashtë. Ky vlerësim mund të rishikohet më shpesh, në varësi të rezultateve të ekzaminimeve të plota ose të pjesshme në vend.

¹ Arsyeja e përcaktimit të këtij afati lidhet ngushtë me periodicitetin e daljes së të dhënave të sistemit bankar, me fokus muajin dhjetor.

Si rregull, profili i rrezikut të çdo banke do të monitorohet, çdo 3 muaj, nëpërmjet treguesve sasiore të raportuar në Sistemin Raportues të Unifikuar, për të cilët janë përcaktuar kufijtë e Sistemit të Paralajmërimit të Hershëm, si dhe raportimeve ad hoc të kërkuara nga bankat.

Në bazë të profilit të rrezikut dhe të faktorëve që mund të jenë specifikë për banka të ndryshme, do të ndërtohet parashikimi i aktiviteteve mbikëqyrëse që duhet të kryhen minimalisht gjatë vitit në vazhdim, tërësia e të cilave përbën ciklin e mbikëqyrjes për secilën bankë.

Për qëllime të procesit mbikëqyrës, fokusi i burimeve dhe kapaciteteve mbikëqyrëse do të jetë më i madh në bankat, të cilat:

1. janë me rëndësi sistemike, sipas përcaktimit të Bankës së Shqipërisë;
2. kanë profil të përgjithshëm ose rreziqe/elemente të veçanta të vlerësuara 4, 5 apo 6;
3. mbikëqyrja nga jashtë ka identifikuar sinjalizime negative për rreziqe specifike apo prirje përkeqësuese të treguesve të veprimtarisë së bankës;
4. janë në proces shndërrimi apo ristrukturimi të të gjithë aktivitetit apo të linjave kryesore të veprimtarisë, ose janë në vitin e parë të aktivitetit të tyre.

Departamenti i Mbikëqyrjes, duke u mbështetur në këto prioritete, planifikon minimalisht aktivitetet që duhen kryer brenda ciklit mbikëqyrës, të cilat detajohen më poshtë.

1. *Kërkesa për raportim periodik mujor* sipas kërkesave të sistemit të raportimit të unifikuar (SRU) ose me periodicitet më të shpeshtë, si dhe raportime të tjera shtesë që nuk përfshihen në SRU, në rastet kur gjykohet e arsyeshme nga Departamenti i Mbikëqyrjes i Bankës së Shqipërisë. Verifikimi i saktësisë së këtyre raportimeve është proces mjaft i rëndësishëm i mbikëqyrjes në vend.
2. *Monitorim mujor dhe 3-mujor* i gjendjes financiare të bankës dhe i treguesve të përcaktuar sipas llojit të rreziqeve. Frekuenca mund të jetë më e lartë për rreziqe të caktuara, në varësi të nivelit të vlerësimit të tyre.
3. *Takime me administratorët e lartë të bankës* përgjegjës për mbarëvajtjen e veprimtarisë së saj, duke përfshirë edhe strukturat e menaxhimit të rrezikut dhe kontrollit të brendshëm.
4. *Takim me auditorin e jashtëm të bankës.*
5. *Të paktën një takim dhe shkëmbim korrespondence* me përfaqësues të Këshillit Drejtues të bankës ose të bankës mëmë, në rastin e degës së bankës së huaj, dhe/ose përfaqësues të asamblesë së aksionerëve të saj. Këto takime mund të kenë frekuencë më të shpeshtë, në varësi të rëndësisë së çështjeve të identifikuara gjatë procesit të mbikëqyrjes nga jashtë.
6. *Takim dhe/ose shkëmbim i zgjeruar informacioni*, mbi bazën e marrëveshjeve dypalëshe, me autoritetin mbikëqyrës të vendit ku banka ka selinë qendrore, në rastin e një dege të një banke të huaj apo filiali të saj ose kur është pjesë e një grupi të huaj bankar/financiar. Pjesëmarrja në kolegjet e mbikëqyrësve do të shërbejë si instrument i rëndësishëm për realizimin e këtij aktiviteti.
7. *Ekzaminim i plotë ose i pjesshëm në vend (në një bankë ose disa banka horizontalisht)* në bankat e planifikuara për t'u ekzaminuar, bazuar në procesin e monitorimit dhe vlerësimit të profilit të rrezikut, në ndjekjen e rekomandimeve apo dhe në monitorimin e zhvillimeve të tjera të paparashikuara. Në çdo rast, të gjitha bankat sistemike duhet t'i nënshtrohen një ekzaminimi të plotë brenda një harku kohor maksimal 2-vjeçar ose, gjatë kësaj periudhe, të vlerësohen në vend të gjitha rreziqet dhe

elementet e veçanta me ekzaminime të pjesshme. Bankat e tjera (josistemike), në çdo rast, duhet t'i nënshtrohen një ekzaminimi të plotë brenda një harku kohor maksimal 3-vjeçar ose, gjatë kësaj periudhe, të vlerësohen në vend të gjitha rreziqet dhe elementet e veçanta me ekzaminime të pjesshme.

7. ELEMENTE TË PROCESIT MBIKËQYRËS

Mbikëqyrja bankare në Republikën e Shqipërisë kryhet nga Banka e Shqipërisë, e cila e përmbush këtë funksion kryesisht nëpërmjet Departamentit të Mbikëqyrjes. Në rastin e degëve dhe/ose filialeve të bankave të huaja që operojnë në Republikën e Shqipërisë, procesi i mbikëqyrjes synohet të realizohet në bashkëpunim me autoritetin mbikëqyrës të vendit ku banka mëmë ka selinë e saj qendrore. I njëjti bashkëpunim ofrohet edhe për autoritetet mbikëqyrëse të vendit të huaj ku një bankë me seli qendrore në Republikën e Shqipërisë ka degën(t) dhe ose filialin/et e saj.

Në Departamentin e Mbikëqyrjes, të gjitha njësitë e strukturës organizative të tij funksionojnë si pjesë e një mekanizmi të vetëm, i cili nëpërmjet shkëmbimit në kohën e duhur dhe në mënyrë të plotë të informacionit dhe të përfshirjes në vendimmarrje, si dhe koordinimit të veprimeve të nevojshme dhe transparencës së tyre, bën të mundur kryerjen me sukses të procesit mbikëqyrës.

7.1. Licencimi

Procesi i mbikëqyrjes fillon me licencimin e subjekteve që kërkojnë të kryejnë veprimtari bankare dhe financiare në Republikën e Shqipërisë. Procesi i licencimit mbështetet në kuadrin ligjor dhe rregullativ në fuqi dhe në Politikën e Licencimit.

Qëllimi kryesor i licencimit është lejimi i hyrjes në sistemin bankar dhe financiar të subjekteve që premtojnë të zbatojnë standardet më të mira ndërkombëtare për administrimin e përgjegjshëm të subjektit, për ushtrimin e veprimtarive bankare dhe financiare të qëndrueshme dhe me rreziqe të kontrolluara dhe të mirëadministruara, të mbështetura me burime të mjaftueshme të kapitalit dhe të likuiditetit për përballimin e vështirësive në situata krizash. Përveç objektivave të biznesit, subjektet që hyjnë në tregun bankar dhe financiar duhet të mbështesin zhvillimin e ekonomisë së vendit, nëpërmjet ofrimit të produkteve dhe shërbimeve bankare cilësore dhe eficiente.

7.2. Kuadri rregullativ mbikëqyrës

Kuadri rregullativ mbikëqyrës mbështetet dhe hartohet në zbatim të ligjit "Për Bankën e Shqipërisë", të ligjit "Për bankat në Republikën e Shqipërisë" dhe të akteve të tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi. Ai përfshin tërësinë e rregullave të vendosura nga Banka e Shqipërisë për licencimin dhe mbikëqyrjen e bankave dhe/ose subjekteve të tjera financiare jobanka.

Rregulloret e licencimit përcaktojnë kërkesat që duhet të plotësohen në momentin që një subjekt aplikon për të marrë licencë bankare dhe/ose financiare, ndërsa rregulloret e mbikëqyrjes përcaktojnë rregullat e kujdesit që duhet të zbatohen nga subjekti përgjatë gjithë veprimtarisë së tij, me qëllim sigurimin e një veprimtarie financiare të qëndrueshme dhe të shëndetshme, mbrojtjen e stabilitetit të sistemit bankar dhe financiar, si dhe të interesave të depozituesve.

7.2.1 PARIMET E KUADRIT RREGULLATIV MBIKËQYRËS

Kuadri rregullativ mbikëqyrës hartohet në mënyrë të tillë që të jetë:

1. i plotë dhe të përshtatet në vazhdimësi, sipas zhvillimeve të ndryshme në sistemin bankar e financiar brenda ose jashtë vendit, të nevojave të tregut, si dhe të nevojave për përmirësim të evidentuara nga vështirësitë dhe problematika e zbatimit në praktikë të tij;
2. në përputhje me standardet për një mbikëqyrje bankare efektive të Komitetit të Bazelit dhe me direktivat përkatëse evropiane për veprimtarinë e institucioneve të kreditit (bankave) dhe institucioneve të tjera financiare;
3. në përputhje me standardet dhe praktikat më të mira ndërkombëtare, për veprimtarinë/të bankare e financiare;
4. i ndërtuar mbi bazën e një procesi të mjaftueshëm konsultimi paraprak dhe në vijimësi, ku shkëmbehen mendime në formë diskutimi ose me shkrim, brenda institucionit dhe me përfaqësues të palëve të interesuara (banka, institucione financiare jobanka, zyra të këmbimit valutor, unione dhe shoqëri të kursim kreditit etj.);
5. i qartë dhe i kuptueshëm për subjektet që do ta zbatojnë dhe për grupet e tjera të interesuara që do konsultohen me të, me qëllim shmangien e keqinterpretimeve dhe zbatimin efektiv të tij në praktikë.

7.2.2 RISHIKIMI

Kuadri rregullativ mbikëqyrës do të rishikohet në rastet kur:

1. zbatimi i plotë i tij në praktikë është i pamundur për arsye objektive;
2. kanë ndodhur ndryshime paralele në aktet e tjera ligjore dhe/ose rregullative përkatëse;
3. zhvillimet e sistemit apo të tregut diktojnë ndryshime të kërkesave ose normave rregullative;
4. rishikimi është në funksion të zbatimit të standardeve të reja në fushën e mbikëqyrjes bankare;
5. etj.

7.2.3 PUBLIKIMI

Çdo ndryshim i miratuar në kuadrin rregullativ mbikëqyrës bëhet i njohur për departamentet e Bankës së Shqipërisë dhe subjektet e tjera të interesuara. Ato publikohen sipas procedurave dhe kërkesave ligjore përkatëse, në Buletinin Zyrtar dhe/ose në faqen zyrtare të internetit të Bankës së Shqipërisë, si dhe në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.

Çdo ndryshim si më sipër publikohet në faqen zyrtare të internetit të Bankës së Shqipërisë dhe përkthehet në gjuhën angleze.

Një funksion mbështetës, brenda kuadrit të procesit të hartimit dhe rishikimit të rregulloreve të mbikëqyrjes bankare, është dhe funksioni i metodologjisë, i cili konsiston në përmirësimin e vazhdueshëm metodologjik dhe praktik të procesit mbikëqyrës, me qëllim bashkërendimin të tij me standardet dhe praktikat më të mira ndërkombëtare.

Fokusi kryesor i këtij funksioni ka të bëjë me zhvillimin metodologjik të kuadrit mbikëqyrës, sipas nevojave dhe kërkesave, nga sektorë të tjerë të mbikëqyrjes që monitorojnë rreziqet kredi dhe jokredi, si edhe sipas zhvillimeve të ndryshme në treg dhe nevojës për ndryshime apo përmirësim të kuadrit rregullativ.

7.3. Mbikëqyrja nga jashtë

Mbikëqyrja nga jashtë ka si qëllim të monitorojë, në mënyrë dinamike dhe nëpërmjet një procesi proaktiv, gjendjen financiare të çdo banke, të grupeve bankare/financiare dhe të sistemit bankar në tërësi, duke identifikuar problemet ekzistuese dhe të së ardhmes, si dhe të shërbejë si një sistem i paralajmërimit të hershëm.

Puna për mbikëqyrjen nga jashtë të bankave mbështetet në raportet financiare të standardizuara (Sistemi Raportues i Unifikuar) dhe të raporteve shtesë të kërkuara sipas rastit nga Departamenti i Mbikëqyrjes, si dhe burimeve të tjera të informacioni të Bankës së Shqipërisë, të cilat mundësojnë identifikimin në kohë dhe sa më të shpejtë të zhvillimeve negative apo të pafavorshme në treguesit e bankës.

Këta tregues analizohen dhe krahasohen me prirjet e tyre historike, si dhe me performancën ndaj grupeve bankare/financiare dhe sistemit në tërësi.

Në bazë të këtyre analizave identifikohen problemet ekzistuese, duke kontribuar në mënyrë të drejtpërdrejtë në përcaktimin e prioriteteve dhe përdorimin efektiv të burimeve mbikëqyrëse në fushat dhe veprimtaritë me rrezik më të madh.

Departamenti i Mbikëqyrjes, duke u mbështetur në kuadrin ligjor dhe rregullativ dhe në iniciativën e njësive që kryejnë mbikëqyrjen nga jashtë të veprimtarisë së bankës, mund të kërkojë, në situata të jashtëzakonshme, që banka të veçanta dhe me zhvillime negative apo të pafavorshme në profilin e rrezikut, të raportojnë të dhëna shtesë ose me frekuencë më të shpeshtë, krahas raportimit të detyrueshëm në kushte normale. Kërkesat shtesë për raportim synojnë të sigurojnë informacion të nevojshëm dhe të vazhdueshëm për zhvillimet në tregues të ndryshëm të bankës që janë subjekt i masave korrektuese, si dhe shërbejnë për vlerësimin e ecurisë së bankës dhe të administratorëve të saj për zgjidhjen e problemeve dhe zbatimin e rekomandimeve.

Mbikëqyrja nga jashtë është instrumenti kryesor nëpërmjet të cilit mbikëqyrjen bankat në periudhën ndërmjet dy ekzaminimeve në vend.

Nëpërmjet këtij procesi synohet të:

1. identifikohen në kohë ndryshimet në treguesit e një banke, si dhe të monitorohet prirja e tyre;
2. verifikohen në kohë ndryshimet në treguesit dhe/ose problematikat që kanë qenë subjekt i veprimeve korigjuese;
3. nxirren konkluzione mbi ecurinë e bankave të veçanta, në lidhje me ekspozimin e tyre ndaj rreziqeve të ndryshme, si dhe gjykohet mbi profilin e rrezikut të gjithë sistemit, veçanërisht për rrezikun e kredisë, rrezikun e tregut dhe atë likuiditetit;
4. ofrohet një burim informacioni që mund të përdoret nga Departamenti i Mbikëqyrjes, departamente të tjera të interesuara, si edhe nga administratorët e bankës, me qëllim njohjen e gjendjes reale të bankave të veçanta dhe të sistemit bankar në përgjithësi dhe, sipas nevojës, të reagimit në një kohë sa më të shpejtë.

Nga ana tjetër, mbikëqyrja nga jashtë kujdeset që të dhënat që vijnë nëpërmjet sistemit raportues nga ana e bankave:

1. të kenë kuptim dhe të përfaqësojnë në mënyrë të qenësishme dhe të saktë veprimtarinë e tyre;
2. të jenë të plota dhe në përputhje me standardet më të mira në këtë drejtim, duke gjeneruar propozimet për ndryshime, nëse praktika dhe standardet më të mira e kërkojnë një gjë të tillë;
3. të shërbejnë për evidentimin në mënyrë periodike të ecurisë së treguesve të veprimtarisë së bankës dhe të elementeve që janë subjekt i drejtpërdrejtë i kuadrit rregullativ;
4. të ofrojnë informacionin e nevojshëm, sipas rastit, të përmbledhur ose të detajuar, mbi bazën e të cilit mund të ndërtohen analiza ose studime, të cilat të përfshijnë çdo element të veprimtarisë së bankës.

Në përfundim të procesit të mbikëqyrjes nga jashtë do të shpërndahen rezultatet përkatëse për të gjithë Departamentin e Mbikëqyrjes, duke tërhequr vëmendjen për tregues të cilët:

1. shfaqin një sjellje të panatyrshme;
2. kanë një prirje negative, e cila mund të çojë në shkeljen e kufijve të përcaktuar në kuadrin rregullativ;
3. kanë qenë subjekt i rekomandimeve për përmirësim nga Banka e Shqipërisë, për të cilët kërkohet ndjekje e vazhdueshme;
4. kanë shkelur kufijtë e përcaktuar në kuadrin rregullativ;
5. tërheqin vëmendjen për arsye të tjera.

PRODUKTET E MBIKËQYRJES NGA JASHTË

Mbikëqyrja nga jashtë, me qëllim ndjekjen nga afër dhe rritjen e eficiencës së analizave të gjendjes financiare, duhet konceptuar me orientim nga specializimi, gjë që do të thotë se çdo kategori rreziku analizohet nga një grup mbikëqyrësish të caktuar. Ky grup mbikëqyrësish analizon në vijimësi të gjitha bankat dhe merr pjesë në procesin e mbikëqyrjes në vend.

Analizat e mbikëqyrjes nga jashtë, të konceptuara sipas paragrafit të mësipërm, dokumentohen dhe

shërbejnë për një vlerësim të përgjithshëm të profilit të rrezikut për bankat, me qëllim sigurimin e vijueshmërinë së procesit mbikëqyrës.

Produktet kryesore të mbikëqyrjes nga jashtë, paraqiten si më poshtë.

1. Raporti mbi tendencat kryesore dhe problematikën e bankave, grupeve bankare ose financiare
Periodicitet mujor

Ky raport është një instrument i rëndësishëm që përdoret për të monitoruar dhe analizuar bankat individuale. Ai përbën një analizë të përgjithshme të ecurisë së treguesve të bilancit, pasqyrës së të ardhurave e të shpenzimeve, dhe të dhënave të tjera periodike.

2. Analiza e Sistemit të Paralajmërimit të Hershëm për çdo bankë
Periodicitet 3 (tre)-mujor

Kjo analizë përfaqëson një grup treguesish dhe koeficientësh që shërbejnë për të identifikuar mundësitë për tejkalimin e normave të mbikëqyrjes, ose masën e ekspozimit ndaj ndonjë rreziku të veçantë. Për çdo tregues përcaktohen kufijtë brenda të cilëve është normal ndryshimi i tyre. Sistemi i Paralajmërimit të Hershëm identifikon problematikën e çdo banke. Shmangiet nga kufijtë normalë të treguesve të monitoruar mund të kërkojnë kryerjen e ekzaminimeve të shënjestruara, si dhe të nxisin ndryshime në veprimet e mëparshme korrigjuese ose në strategjinë e mbikëqyrjes.

3. Vlerësimi dhe ecuria e elementit sasior të sistemit të vlerësimit të rreziqeve për secilën bankë
Periodicitet 3 (tre)-mujor

Përmes tij kryhet vlerësimi i elementit sasior në sistemin e vlerësimit të përgjithshëm të bankës. Po ashtu, evidenton ecurinë në kohë, përgjatë vitit të fundit, të këtij elementi për bankën dhe synon në evidentimin e hershëm të profilit të saj të rrezikut. Ai pasqyron gjithashtu edhe shkeljet në zbatimin e kërkesave të kuadrit ligjor dhe rregullator të mbikëqyrjes.

4. Analiza mbi zhvillimet në banka, grupet bankare ose financiare
Periodicitet 3 (tre)-mujor

Kjo analizë shërben për të dhënë një vlerësim të sistemit financiar sipas profileve të rrezikut dhe për të identifikuar zhvillimet kryesore, rreziqet ndaj të cilave është i ekspozuar sistemi financiar për periudhën e marrë në konsideratë, si edhe evidentimin e prirjes afatshkurtër të zhvillimeve në të ardhmen.

5. Vlerësim i profilit të përgjithshëm të rrezikut për secilën bankë
Periodicitet vjetor

Ky vlerësim konsiston në paraqitjen e profilit të përgjithshëm të rrezikut për bankën, bazuar në sistemin SRV. Si rregull, kjo analizë rishikohet një herë në vit (kryesisht brenda tremujorit të parë të vitit pasardhës)²,

² Arsyeja e përcaktimit të këtij afati lidhet ngushtë me periodicitetin e daljes së të dhënave të sistemit bankar, me fokus muajin dhjetor.

duke përfshirë në vlerësim informacionin nga ekzaminimet në vend dhe nga analizat nga jashtë. Ky vlerësim mund të rishikohet më shpesh, në varësi të rezultateve të ekzaminimeve të plota ose të pjesëshme në vend.

6. Strategjia e mbikëqyrjes për secilën bankë
Periodicitet vjetor

Strategjia e mbikëqyrjes së bankës është dokumenti që jep, në mënyrë të përmbledhur dhe të plotë, informacionin mbi modelin e biznesit të bankës, vlerësimin e profilit të rrezikut të saj, elementet ku mbështetet ky vlerësim, përshkrimin e aktiviteteve mbikëqyrëse etj.

Hartimi i këtij dokumenti mbështetet në informacionin që sigurohet nëpërmjet ekzaminimeve në vend, kontakteve me bankën ose subjektet e lidhura me të, konkluzionet e mbikëqyrjes nga jashtë, nga njësi të tjera të Departamentit të Mbikëqyrjes ose të Bankës së Shqipërisë, nga autoriteti mbikëqyrës në vendin e origjinës etj.

Strategjia e mbikëqyrjes së bankës përditësohet pas çdo vlerësimi të profilit të përgjithshëm të rrezikut të saj.

7.4 Mbikëqyrja në vend

Mbikëqyrja në vend është pjesë e procesit të mbikëqyrjes që realizohet nëpërmjet ekzaminimeve në vend të aktivitetit të bankës. Ajo ka për qëllim vlerësimin e situatës së përgjithshme dhe rreziqeve të veçanta të bankës, nëpërmjet vlerësimit të aktiviteteve të saj. Ky proces plotëson, qartëson dhe konsolidon informacionin dhe vlerësimin e siguruar nëpërmjet mbikëqyrjes nga jashtë.

7.4.1. LLOJET E EKZAMINIMEVE NË VEND

1. *Ekzaminimi i plotë* shtrihet në të gjithë aktivitetin e bankës dhe të subjekteve të lidhura me të. Gjatë këtij ekzaminimi konkludohet me një vlerësim të përbërësve të sistemit të vlerësimit të rrezikut dhe në përcaktimin e profilit të përgjithshëm të rrezikut për bankën.
2. *Ekzaminimi i pjesëshëm/shënjestruar* është çdo lloj ekzaminimi, i cili shtrihet në një ose disa drejtime të veprimtarisë së bankës. Ai zhvillohet kryesisht në drejtimet që kanë lidhje me rreziqet e veçanta të identifikuar nëpërmjet mbikëqyrjes nga jashtë, në kontaktet me organet drejtuese të bankës, në raportimet mbi zbatimin e rekomandimeve, në kontrollin e pasqyrave financiare të bankës dhe/ose të subjekteve të lidhura me të, në bashkëpunim me departamente të tjera të Bankës së Shqipërisë, si dhe mbi të dhënat e marra nga burime të ndryshme të ligjshme të informacionit. Si rregull, ky lloj ekzaminimi është i kufizuar në kohë, burime dhe në procedura.
3. *Ekzaminimet horizontale* janë ekzaminime të pjesëshme që zhvillohen paralelisht në disa subjekte bankare, me qëllim verifikimin e një fenomeni të përbashkët ose vlerësimin e një rreziku, ekspozimi ndaj të cilit gjykohet se ka ndikim sistemik të lartë.

7.4.2. FAZAT E PROCESIT TE EKZAMINIMIT NË VEND

1. *Identifikimi i nevojës për ekzaminim* përcaktohet mbi bazën e aktiviteteve të parashikuara në ciklet mbikëqyrëse, nga sinjalizime të mbikëqyrjes nga jashtë, nga zhvillime të caktuara ekonomike në vend, nga sinjalizime të departamenteve të tjera në Bankën e Shqipërisë, si dhe nga burime të tjera të ligjshme të informacionit.
2. *Caktimi i grupit të ekzaminimit dhe ndarja e detyrave brenda grupit* kryhet duke u bazuar kryesisht në objektin e ekzaminimit, si dhe në ndarjen e përgjegjësive ndërmjet njësive organizative të Departamentit të Mbikëqyrjes. Në çdo ekzaminim në vend marrin pjesë të paktën dy punonjës të Departamentit të Mbikëqyrjes. Përbërja dhe numri i grupit të ekzaminimit varion në varësi të madhësisë dhe kompleksitetit të veprimtarisë së subjektit që ekzaminohet. Grupi i ekzaminimit udhëhiqet nga ekzaminuesi përgjegjës.
3. *Hartimi dhe dërgimi në bankë i programit të ekzaminimit*, në të cilin përcaktohet qartë se ekzaminimi mund të dalë përtej objektit dhe periudhës kohore së cilës i referohet, nëse do të gjykohet e arsyeshme nga grupi i ekzaminimit. Në një rast të tillë do të ketë shtyrje të periudhës për të cilën kërkohet dokumentacioni në bankë.
Si rregull, midis datës së dërgimit të programit të ekzaminimit dhe fillimit të tij lejohet një periudhë kohore minimale prej 10 (dhjetë) ditësh pune. Megjithatë, përjashtime nga ky rregull mund të ketë në rastet e ekzaminimeve të pjesshme/shënjestruara.
Nëse banka kërkon, në mënyrë zyrtare me argumente, shtyrje të afatit për fillimin e ekzaminimit, Departamenti i Mbikëqyrjes mund ta pranojë këtë kërkesë nëse argumentet konsiderohen të mjaftueshme/pranueshme.
4. *Hartimi i dokumentit të paraekzaminimit* mbështetet në informacionin e grumbulluar për qëllime mbikëqyrëse, duke përfshirë edhe informacionin e vënë në dispozicion paraprakisht nga banka, bazuar në programin e ekzaminimit. Ai është një dokument i brendshëm i Departamentit të Mbikëqyrjes, i cili përcakton fushat kryesore të aktivitetit të bankës, të cilave do t'i kushtohet kujdes i veçantë gjatë ekzaminimit.
5. *Takimi prezantues me drejtuesit e bankës* organizohet pas dërgimit të planit të punës dhe përpara fillimit të ekzaminimit. Në takim marrin pjesë ekzaminuesi përgjegjës dhe një ose disa prej anëtarëve të grupit të ekzaminimit.
6. *Kryerja e ekzaminimit në vend* konsiston në verifikimin e situatës së përgjithshme dhe rreziqeve të veçanta të bankës, nëpërmjet prezencës fizike të grupit të ekzaminimit pranë saj. Kohëzgjatja e këtij procesi është në funksion të profilit të rrezikut të vlerësuar përmes mbikëqyrjes nga jashtë. Ekzaminuesi përgjegjës përfaqëson grupin e ekzaminimit në komunikimin me drejtuesit e bankës. Në momentin e përfundimit të ekzaminimit në vend, ekzaminuesi përgjegjës dhe grupi i ekzaminimit realizojnë një takim përmbyllës, nëpërmjet të cilit njohin drejtuesit e bankës së ekzaminuar me problemet kryesore të konstatuara nga grupi i ekzaminimit. Pavarësisht prezantimit të situatës nga ana e grupit të ekzaminimit, konkluzionet dhe vlerësimi përfundimtar i situatës së bankës nxirret pas diskutimit me drejtuesit e Departamentit të Mbikëqyrjes.
7. *Përgatitja e raportit të ekzaminimit*, i cili është një dokument zyrtar i Departamentit të Mbikëqyrjes dhe si i tillë, është konfidenciale, pra i disponueshëm vetëm për Këshillin Drejtues dhe drejtuesit e lartë të bankës. Ai nuk i duhet dhënë, as pjesërisht e as tërësisht, asnjë njësie tjetër, personi apo organizate, pa miratimin paraprak të Bankës së Shqipërisë.

8. *Prezantimi i konkluzioneve në bankë dhe dërgimi i raportit të ekzaminimit.* Pas hartimit të raportit përfundimtar të ekzaminimit, ekzaminuesi përgjegjës dhe një/disa anëtarë të grupit të ekzaminimit organizojnë një takim zyrtar me drejtuesit e lartë të bankës, ku prezantohen konkluzionet e arritura dhe rekomandimet kryesore të ekzaminimit. Në varësi të shqetësimeve mbikëqyrëse të konstatuara gjatë ekzaminimit dhe/ose madhësisë së bankës, në takim marrin pjesë edhe drejtues të Departamentit të Mbikëqyrjes ose Administratorët e Bankës së Shqipërisë.
Në rast të ndryshimeve materiale ndërmjet konkluzioneve të ekzaminimit dhe zhvillimeve të mëvonshme në bankë, grupi i ekzaminimit, pas konsultimit me drejtuesit e departamentit, i merr ato në konsideratë dhe bën pasqyrimin e duhur në raportin e ekzaminimit.
Si rregull, periudha që nga përfundimi i ekzaminimit deri në dorëzimin e raportit përfundimtar të ekzaminimit nuk duhet të jetë më shumë se 30 (tridhjetë) ditë pune.
9. *Dërgimi i planit të masave nga ana e bankës dhe dorëzimi i formularit me firmat e administratorëve të bankës.* Plani i masave përmban qëndrimin e përgjithshëm të bankës mbi konkluzionet e ekzaminimit të kryer, masat që do të merren për adresimin e shqetësimeve mbikëqyrëse, si dhe zbatimin e rekomandimeve së bashku me afatet përkatëse.
Banka, brenda një periudhë kohe prej 20 (njëzetë) ditësh pune pas mbërritjes së raportit të ekzaminimit, dorëzon planin e masave në Bankën e Shqipërisë. Nëse ky reagim i bankës nuk vjen brenda kohës së përcaktuar dhe kjo vonesë nuk justifikohet paraprakisht nga ana e bankës, rekomandimet dhe afatet e dërguara në raport konsiderohen përfundimtare. Njëkohësisht banka duhet të dërgojë pranë Departamentit të Mbikëqyrjes, formularin "firmat e administratorëve", në afatin e përcaktuar më sipër, si pjesë të dokumentimit të njohjes së administratorëve të bankës me raportin e ekzaminimit.
Nëse banka kërkon me argumente shtyrje të afatit për dërgimin e planit të masave, Banka e Shqipërisë pranon këtë shtyrje që, në çdo rast, nuk duhet të jetë më shumë se 30 (tridhjetë) ditë pune nga dorëzimi i raportit të ekzaminimit.
10. *Përgjigjja ndaj planit të masave* përmban qëndrimin përfundimtar të Bankës së Shqipërisë mbi konkluzionet e ekzaminimit dhe mbi afatet e rekomandimeve.
11. *Ndjekja e zbatimit të rekomandimeve* është një proces i vazhdueshëm pas përfundimit të ekzaminimit në vend. Banka duhet të raportojë periodikisht lidhur me statusin e plotësimit të rekomandimeve.

7.5. Masat mbikëqyrëse

Me qëllim sigurimin e një veprimtarie të sigurt dhe të qëndrueshme, Banka e Shqipërisë, në kuadër të mbikëqyrjes së subjekteve të licencuara dhe mbikëqyrura prej saj, mund të vendosë një sërë masash mbikëqyrëse të përcaktuara në ligjin "Për bankat".

Masat mbikëqyrëse synojnë ndërprerjen e veprimeve të cilat janë në kundërvajtje, si dhe ndreqjen e shkeljeve të evidentuara, për një veprimtari të sigurt dhe të qëndrueshme, duke përcaktuar afate konkrete kohore, të cilat duhet të respektohen nga banka.

7.6. Komunikimi

7.6.1. KOMUNIKIMI BRENDA DEPARTAMENTIT TË MBIKËQYRJES

Materialet dhe produktet që realizohen në Departamentin e Mbikëqyrjes, i nënshtrohen një procesi komunikimi, diskutimi dhe shkëmbimi opinionesh, gjatë fazës së përgatitjes së tyre. Ky proces duhet të jetë i dokumentuar, në formë të shkruar.

Në përgjithësi, të gjitha njësitë përbërëse të Departamentit të Mbikëqyrjes, duhet ta shpërndajnë në kohë reale informacionin që shërben për qëllime të procesit mbikëqyrës. Produktet e secilës njësi të Departamentit Mbikëqyrës janë të aksesueshme nga çdo njësi tjetër e departamentit. Dhënia e mendimeve për informacionin ose materialet që qarkullojnë në Departamentin e Mbikëqyrjes, veçanërisht kur kjo gjë kërkohet nga punonjësi ose njësia dërguese, është një detyrim i hallkave të tjera të Departamentit të Mbikëqyrjes.

Nëse ndeshet një informacion që klasifikohet si "sekret bankar", kjo i bëhet e ditur fillimisht drejtuesve të departamentit, të cilët më pas vendosin për shpërndarjen ose jo të tij në departament. Në rastin kur informacioni që shpërndahet ka një rëndësi më të madhe (të veçantë) për një punonjës ose një njësi të caktuar të Departamentit të Mbikëqyrjes, kjo theksohet në momentin e shpërndarjes së informacionit, duke tërhequr vëmendjen edhe mbi problemin kryesor që ai trajton.

Vendimmarrja në Departamentin e Mbikëqyrjes kryhet në përputhje me matricën e vendimmarrjes, rregulloren e Departamentit të Mbikëqyrjes, si dhe modalitetet e parashikuara në këtë dokument.

7.6.2. KOMUNIKIMI ME NJËSITË E TJERA TË BANKËS SË SHQIPËRISË

Komunikimi i Departamentit të Mbikëqyrjes me njësitë e tjera brenda Bankës së Shqipërisë, me qëllim realizimin e suksesshëm të funksionit të mbikëqyrjes bankare dhe financiare, është një tipar i qenësishëm i departamentit.

Ky komunikim do të jetë në funksion të këtyre elementeve:

- detyrimit për të raportuar pranë Administratorëve dhe Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë për punën e kryer, në formën dhe mënyrën e përcaktuar, si edhe për të mbështetur vendimmarrjen;
- ruajtjes së informacionit që klasifikohet "sekret bankar";
- sigurimit të informacionit të nevojshëm për qëllime të aktivitetit mbikëqyrës;
- rritjes së transparencës për punën e kryer në Departamentin e Mbikëqyrjes;
- dhënies së informacionit, i cili nuk lidhet vetëm me Departamentin e Mbikëqyrjes, por edhe me njësi të tjera të Bankës së Shqipërisë;
- marrjes/dhënies së mendimeve për materiale të ndryshme të Departamentit të Mbikëqyrjes ose të njësive të tjera të Bankës së Shqipërisë;
- shkëmbimit të përvojës për probleme të ndryshme, në formën e bashkëpunimeve në grupe pune të përbashkëta, seminare, takime diskutimi etj.

Komunikimi duhet të jetë i vazhdueshëm për çështje të rëndësishme dhe konkrete.

7.6.3. KOMUNIKIMI JASHTË BANKËS SË SHQIPËRISË

Departamenti i Mbikëqyrjes, krahas bankave dhe institucioneve të tjera që mbikëqyr, komunikon edhe me institucione të tjera dhe individë, duke vendosur në qendër të këtij komunikimi çështje të procesit mbikëqyrës. Komunikimi me shkrim në emër të Departamentit të Mbikëqyrjes, realizohet vetëm nga drejtuesit e Departamentit të Mbikëqyrjes ose nga administratorët e Bankës së Shqipërisë.

Ndërkohë, për informacione që kërkohen brenda një kohe të shkurtër ose për çështje të natyrës informuese, e drejta e komunikimit me anë të postës elektronike ose me telefon, në emër të Departamentit të Mbikëqyrjes, mund të delegohet tek punonjës të tjerë brenda departamentit, duke specifikuar qëllimin e komunikimit dhe kohën gjatë së cilës do të ushtrohet kjo e drejtë.

Elementet mbi të cilat bazohet ky komunikim janë:

- kontaktet e vazhdueshme me bankat, me qëllim ndjekjen e ecurisë së tyre, zbatimin e rekomandimeve të lëna, në afat dhe me cilësi, dhe identifikimin dhe zgjidhjen e problemeve të ndryshme në kohë të hershme;
- kontaktet e takimet periodike midis përfaqësuesve të Departamentit të Mbikëqyrjes dhe përfaqësuesve të bankave, për adresimin e çështjeve të ndryshme që shqetësojnë të dyja palët;
- takimet e rregullta të drejtuesve të Departamentit të Mbikëqyrjes dhe përfaqësuesve të Këshillit Drejtues, për të diskutuar mbi nivelin e koherencës midis sipërmarrjes ndaj rrezikut, nivelit të tolerancës ndaj tij, profilit real të rrezikut të bankës, strategjisë dhe nivelit të kapitalit, shqetësimeve mbikëqyrëse etj;
- takime me përfaqësuesit e asamblesë së aksionerëve të bankës, për adresimin e çështjeve që lidhen me pronësinë e kapitalit, kërkimin e investitorëve strategjikë, si dhe çështje të tjera që kërkojnë zgjidhje nga ky organ;
- takimet e rregullta midis përfaqësuesve të Departamentit të Mbikëqyrjes dhe përfaqësuesve të auditorit të jashtëm, i cili auditon bankën, me qëllim përqendrimin në problemet kryesore që shfaqen gjatë kryerjes së aktivitetit bankar, njihjen me këndvështrimin e secilës palë mbi problemet dhe arsyet përkatëse;
- ruajtja e informacionit që konsiderohet "sekret bankar";
- dhënia e mendimeve dhe e vlerësimeve për çështje të ndryshme që bashkojnë veprimtarinë e mbikëqyrjes me atë të institucioneve të tjera;
- respektimi i marrëveshjeve në drejtim të shkëmbimit të informacionit me institucione të tjera me funksione mbikëqyrëse, brenda dhe jashtë vendit.

Sistemi i Vlerësimit të Rrezikut (SVR)

1. ELEMENTET E SISTEMIT TË VLERËSIMIT TË RREZIKUT

Sistemi i Vlerësimit të Rrezikut përben instrumentin më të rëndësishëm në mbështetje të procesit mbikëqyrës. Ky sistem lejon vlerësimin e ekspozimit ndaj rreziqeve, përshtashmërinë e strukturave organizative dhe të kontrollit të brendshëm, me qëllim arritjen e një gjykimi të përgjithshëm mbi situatën e bankës, mbi bazën e të cilit projektohen veprimet e mundëshme që mund të ndërmerren ndaj saj. Ky sistem përcakton një proces të strukturuar vlerësimi, përgjatë të cilit përdoren, në mënyrë të integruar, mbikëqyrja nga jashtë dhe ekzaminimet në vend, duke synuar përzgjedhjen e instrumentit më të përshtatshëm për arritjen e objektivit.

Mbi bazën e metodave të veçanta të analizës, tipet e rreziqeve që vlerësohen si pjesë e këtij sistemi janë si në vijim:

- rreziku strategjik;
- rreziku organizativ;
- rreziku i kredisë;
- rreziku i likuiditetit;
- rreziku i normës së interesit në librat e bankës;
- rreziku i tregut;
- rreziku operacional dhe rreziku reputacional.

Përveç rreziqeve të mesipërme, Sistemi i Vlerësimit të Rrezikut përfshin edhe elementet e mëposhtëm:

- përfitueshmërinë; dhe
- kapitalin.

2. VLERËSIMI I PËRGJITHSHËM

Vlerësimi i përgjithshëm i bankës është rezultat i vlerësimit për çdo lloj rreziku, përfshirë edhe vlerësimin për përfitueshmërinë dhe mjaftueshmërinë e kapitalit.

Vlerësimi i çdo elementi të Sistemit të Vlerësimit të Rrezikut (SVR) bazohet në dy lloje vlerësimesh: 1) sasiore 2) i cilësore. Përrjashtim nga ky rregull do të përbëjnë:

- rreziku strategjik;
- rreziku organizativ;
- rreziku operacional dhe reputacional;
- përfitueshmëria.

Për tre rreziqet e parë, vlerësimi mbështetet vetëm në elemente cilësore, ndërsa vlerësimi i "përfitueshmërisë" mbështetet vetëm në elemente sasiore.

Në vlerësimin e çdo elementi, vlerësimin cilësor dhe atij sasior i jepet një peshë e njëjtë, duke rezultuar në një nivel vlerësimi nga 1 deri në 6.

Ndërsa, vlerësimi i përgjithshëm i profilit të rrezikut të bankës llogaritet si shumatore e vlerësimeve të çdo rreziku të ponderuara me peshat e përcaktuara në kolonën C të tabelës së paraqitur më poshtë.

Tabelë 1. Sistemi i vlerëimit të Rrezikut (SVR)

Elementet që vlerësohen (A)	Vlerësimi (B)		Pesha në vlerësimin e përgjithshëm (C)
	Sasior	Cilësor	
Rreziku strategjik	-	1-6	3%
Rreziku organizativ	-	1-6	7%
Rreziku i kredisë	1-6	1-6	30%
Rreziku i likuiditetit	1-6	1-6	14%
Rreziku i normës së interesit në librat e bankës	1-6	1-6	4%
Rreziku i tregut	1-6	1-6	2%
Rreziku operacional dhe reputacional	-	1-6	10%
Përfitueshmëria	1-6	-	15%
Kapitali	1-6	1-6	15%
Vlerësimi i përgjithshëm			1 - 6

Renditja që do të rezultojë sipas këtij vlerësimi në një nivel nga 1 deri në 6, do të përcaktojë edhe profilin e rrezikut të bankës, si vijon:

- 1 – “i fortë”;
- 2 – “i kënaqshëm”;
- 3 – “mbi mesatar”;
- 4 – “nën mesatar”;
- 5 – “dobët”;
- 6 – “rrezikshëm”.

